



**Policia e Kosovës**

## **Parandaloni viktimizimin nga grabitjet**

**Në shtëpi:**

- Nëse një i panjohur u troket në derë dhe kërkon nga ju diçka mos i tregoni se jeni vet në shtëpi dhe mos e futni brenda;

Nëse vereni se persona të panjohur po tentojnë të hyjnë dhunshëm në shtëpinë tuaj, atëherë thirrni menjëherë policinë në numrin 192;

- Mos ngurroni t'i thirrni policinë nëse dëgjoni ndonjë zhurmë të pazakontshme afër vendbanimit tuaj ose nëse shihni ndonjë person të panjohur brenda hapësirave të oborrit tuaj;

- Nëse jeni zhvendos në një banesë të re ndërroni cilindrin e detyrës;

- Gjatë natës mbani roletat dhe perdet e lëshuara në dritare;

- Gjatë natës mbani dritën e ndezur të hyrja kryesore;

- Kur dilni nga shtëpia sigurohuni që i keni kontrolluar dhe mbyllur të gjitha dyert dhe dritaret. Mos i lini dritaret gjysmë të hapura (kiper);



Sipas mundësive është e preferuar që brenda shtëpise të vendoset sistemi i kamerave vëzhguese dhe alarmit.

- Pasi të jeni kthyer në shtëpi dhe e shihni se dera e shtëpisë tuaj është e hapur dhe gjërat nuk janë ashtu si i keni lënë mos hyni brenda dhe mos prekni asgjë (sepse mund të demtoni provat e nevojshme për policinë), por vendosuni në një pozitë të sigurt dhe menjëherë thirrni policinë (ka mundësi që hajnat ende të jeni brenda);

- Nëse shihni ndonjë veturë të panjohur duke u larguar nga afërsia e shtëpise suaj, mundohuni të merrni të dhënat e asaj veture (targat, llojin e veturës, ngjyrën etj.).



## Në vendin e punës:

- Kujdesu që hapësira ku ndodhet arka e lokalit tuaj të mos ekspozohet dhe te monitorohet me kamere.
- Në mënyrë periodike të hyrat ditore-paratë, vendosni kohë pas kohe në vend të sigurt-kasaforte. Nëse nuk keni kasaforte gjej ndonjë hapësire tjetër të sigurt për t'i lënë parate.
- Mos mbani shuma të mëdha parash në arkë të lokalit.
- Instaloni kamera të sigurisë dhe alarmin në lokal dhe vendosni shenjen paralajmëruese në vend ku shihet dukshëm se “lokali është nën vëzhgim të kamerave”.
- Nëse jeni duke dërguar para-kesh në bankë mos i tregoni askujt se jeni duke e bërë këtë gjë dhe mundësisht te jeni i shoqëruar nga nje person i besuar.
- Keni kujdes në sjelljet e klientëve , nëse vëreni diçka të dyshuar si qëndrimi në një kohë të gjatë para lokalit dhe shikimi anash, lajmëroni policinë.



### **Në rrugë:**

- Kur jeni duke udhëtuar planifikoni mirë rrugën që do ta përshkoni;
- Mundesisht, shmanguni rrugëve të pa ndriçuar sidomos natën gjatë udhëtimit në këmbë;
- Nëse udhëtoni në këmbë mos mbani të varur në vend të dukshëm ndonjë qafore apo stoli të tjera ari;
- Mos ndalni veturën tuaj në vende të pandriçuar;
- Mundesisht, shmanguni përdorimit të bankomatit gjatë orëve të vona te natës;
- Kur dilni nga vetura mos lini gjërat me vlerë në veturë në hapësira të dukshme. Gjërat e vlefshme vendosni në bagazh tëveturës para se të largoheni nga vetura;
- Para se të largoheni nga vetura juaj kontrolloni që veturën e keni mbyllur mirë, jo vetëm me çelësin pilot por verifikoni edhe me dorë a janë mbyllur të gjitha dyert.

## Si të veproni nëse jeni viktimë e grabitjes:

- Gjatë vet aktit të grabitjes mos bëni ndonjë veprim që do të irriton edhe më tepër grabitësin (më e vlefshme është jeta juaj se gjërat tuaja);
- Nëse grabitësi ju udhëzon të veproni diçka, veproni ashtu si ju thotë me qellim të evitimit të ndonjë lëndimi eventual;
- Nëse mund të aktivizoni ndonjë alarm pa ju vërejtur grabitësi, bëjeni, nëse jo mos rrezikoni;
- Mundohuni të mbani mend se çka ka të veshur grabitësi, sa është i gjatë, çfarë konstruktiv trupor ka;
- Mundohuni të shikoni mirë grabitësin dhe të vëreni ndonjë gjë që e veçon atë si ndonjë shenjë në trup apo diçka ngjashëm;
- Pasi të jetë larguar grabitësi, shënoni të dhënat që i keni mbajtur mend për të që të mos i harroni.
- Shënoni rrugën nga është larguar grabitësi;
- Mundohuni që të merrni të dhënat për veturën me të cilën largohet grabitësi por duke mos rrezikuar vetën;
- Thirrni policinë menjëherë në numrin 192;
- Pasi të jetë kryer grabitja mos prekni asgjë në vendin e ngjarjes, e në veçanti ato gjëra që i ka prekur grabitësi;
- Nëse ka ndonjë person/dëshmitar që e ka parë ngjarjen udhëzoheni që të qëndrojnë aty derisa të vijë policia;
- Nëse ndonjë dëshmitar nuk ka kohë për të pritë policinë, së paku merrni emrin, mbiemrin, adresën dhe numrin e telefoni që policia ta kontaktoj më vonë.

